

NEKROLOGJI

ERIC P. HAMP (1920-2019)

Në 17 shkurt 2019 ndërroi jetë gjuhëtari i shquar dhe albanologu më i madh amerikan Eric Hamp. Ai ishte një studiues i njohur ndërkombëtarisht në fushën e gjuhësisë krahasuese-historike, me interes të veçantë në gjuhët më pak të studiara ku gjuha shqipe me degët e saj të diasporës arbëreshe dhe arvanitase zinte një vend të nderuar. Interesat e tij studimore shtriheshin nga indoeuropianistika, te ballkanologjia, albanologjia, keltologjia, romanistika, sllavistika, armenishtja e deri te gjuhët vendase të Amerikës. Në studimin e gjuhëve atë e shquante kërkimi në terren për të mbledhur lëndën e tyre.

Interesi për gjuhën shqipe atij i lindi në kohën kur kryente studimet pasuniversitare në Harvard dhe shkoi në Itali për të studiuar nga afër të folmet arbëreshe. Sipas prof. Gianni Belluscios, “ishte marsi i vitit 1950 kur prof. Joshua Whatmough i Universitetit të Harvardit, i nisi një letër prof. Carlo Tagliavinit të Universitetit të Bolonjës për t’i rekomanduar një student të doktoratës, i cili shfaqte interes për studimin e shqipes dhe të dialekteve të saj. Pikërisht me atë letër dhe nëpërmjet Tagliavinit fillojnë marrëdhëniet e Eric Hampit me arbëreshët. Pas asaj letre Tagliavini takon Hampin në Bolonjë dhe i propozon të shkojë për të verifikuar në terren diçka të habitshme, faktin që në Kalabri, në provincën e Kozencës, në mes të një numri të madh të folmesh me tipologji toske, ka edhe një të folme për të cilën thuhet që paraqet tipare geqe, e folmja e Vakaricit (Vaccarizzo Albanese). Me atë anketë që zgjati për rreth dy vjet dhe me prezantimin e disertacionit të doktoratës më 1954 nisin kërkimet, studimet, botimet, marrëdhëniet e Hampit për dhe me arbëreshët.”

Ndërkohë që punonte për doktoratën, Hampit i erdhi ftesa për të punuar si lektor i gjuhësisë në Universitetin e Çikagos. Në këtë universitet ai zhvilloi karrierën e tij akademike për më se 40 vjet, duke marrë titujt profesor asistent në vitin 1953, profesor i asociuar në 1958 dhe profesor në 1962, deri më 1991 kur doli në pension, por ligjëratat i vijoi edhe më tej, deri në ditët e fundit të jetës. Për shumë vite ka drejtuar “Revistën Ndërkombëtare të Gjuhësisë Amerikane” dhe kohët e fundit revistën e “Gjuhësisë Antropologjike”, ndërsa më 1965-1991 ka qenë drejtor i Qendrës për Studimet Ballkanike dhe Sllave. Ai ka shkruar një numër mbresëlënës prej mbi 3500 punimesh: artikuj, recensione, shënime etj. Shkrimet që i përkasin gjuhës shqipe janë llogaritur të

jenë rreth 80. Ndër to spikat vepra e tij e madhe për sistemin fonologjik të së folmes arbëreshe të Vakaricës e përfunduar si disertacion doktorate në vitin 1954 dhe botuar në anglisht e italisht në vitin 1993, që mbetet ndër studimet më të plota përshkruese fonologjike për një të folme të shqipes. Më pas ndjekin një varg përshkrimesh për shumë pika nga të folmet arbëreshe të Greqisë e të Italisë, ashtu si dhe për të folmen e Mandricës në Bullgari. Ai është ndër albanologët e paktë që ka vizituar të gjithë fshatrat ku flitet arbërishtja në Greqi dhe në Itali për qëllimet e tij të studimeve, ku janë fiksuar edhe të folme që sot nuk fliten më në Greqi. Eric Hampi ka shkruar zërin për gjuhën shqipe në vëllimin e parë të “Enciklopedisë Britanike”. Në vitin 1963 ai mbajti një referim mbi Pozitën e shqipes në konferencën për Dialektet e lashta indoevropiane në Universitetin e Kalifornisë, ku parashtrroi në mënyrë koncize problematikat kryesore të historisë së gjuhës shqipe duke dhënë mendimin e vet për disa çështje të rrahura e të pazgjidhura përfundimisht. Një numër i madh artikujsh të shkurtër por gjurmëlënës i kushtohen historisë së gjuhës shqipe të parë nga aspektet e krahasimit në rrafshin indo-europian e në atë ballkanik. Vëmendje të posaçme ai u ka kushtuar marrëdhënieve të gjuhës shqipe me gjuhët e Ballkanit, dhe sidomos raporteve me gjuhën rumune. Hampi ka kontribut shumë të rëndësishme në studimin e raporteve të shqipes me mesapishten, që flasin për prejardhjen e shqipes nga ilirishtja, e cila ka pasur marrëdhënie të drejtpërdrejta me mesapishten.

Në gjuhën shqipe janë botuar 4 artikuj të tij për shpjegime historike fjalësh të ndryshme në revistën “Studime filologjike” (1968/3, 1972/1, 1973/3, 1992 1-4), si dhe 7 në revistën “Gjurmime albanologjike” të Prishtinës, duke nisur po ashtu nga viti 1968. Ndërsa anglisht është botuar një artikull në revistën “Studia albanica” (1969, nr. 1). Së fundi, më 2007 është botuar nga ASHAK në Prishtinë një vëllim prej rreth 450 faqesh me studime të përzgjedhura të tij me titullin “Studime krahasuese për shqipen”, nën kujdesin e prof. Rexhep Ismajlit. Në vitin 2010 Universiteti i Kalabrisë, me rastin e 90-vjetorit të lindjes së tij, botoi një vëllim 430 faqesh me studime albanologjike. Në nderim për veprën e tij albanologjike, me rastin e 92-vjetorit të lindjes, Republika e Shqipërisë i kushtoi figurës së Eric Hampit një pullë postare në vitin 2012.

Eric Pratt Hamp ishte anëtar i tri Akademive. Ai ishte që nga viti 1994 anëtar i Akademisë Mbretërore Daneze. Në vitet '90 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe më vonë anëtar nderi edhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Me Kosovën dhe hapësirat shqiptare kompakte jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë prof. Hampi ka pasur lidhje të veçanta. Ai ka kryer vizita studimore në terren në shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi, ka marrë pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, ka mbajtur kontakte dhe ka bashkëpunuar me kolegët dhe institucionet akademike në Prishtinë, duke kontribuar në revistën shkencore “Studime” të ASHAK-ut.

Zhvillimin e ngjarjeve në vitet '80-'90 në Kosovë ai e ka ndjekur me vëmendje, duke mbrojtur çështjen e botimeve në gjuhën shqipe.

Si studiues amerikan, prof. Hampi nuk mund të vinte në Shqipërinë e para viteve '90, e cila nuk kishte marrëdhënie diplomatike me SHBA. Por ai në periodha të ndryshme ka mbajtur korrespondencë me studiues e kolegë nga Shqipëria dhe është takuar me ta në veprimtari shkencore jashtë vendit. Për herë të parë ai erdhi këtu në vitin 1992 dhe më pas në 2008, i ftuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike në edicionin e parë të Ditëve të Albanologjisë, ku u prezantua dhe vëllimi me studime i tij "Studime krahasuese për shqipen", referuar nga prof. R. Ismajli. Botimi u cilësua si një studim i detajuar i gjuhës tonë në rrafsh krahasimtar, që përfshin gramatikën, studimet dialektore, historike, marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje, etj. Në atë rast prof. Hampi mbajti një referat ku mbështeti origjinën ilire të shqipes dhe u ftua të dorëzojë çmimet për veprat më të mira në Albanologji.

Prof. Viktor Friedman, profesor i Universitetit të Çikagos, anëtar nderi i ASH të Shqipërisë dhe ASHA të Kosovës dhe mik e koleg i profesor Eric Hampit, në eulogjinë e tij për prof. Hampin, të cilën na e vuri në dispozicion, thotë ndër të tjera: "Vetë fakti që Erikut i janë dedikuar gjashtë Festschrift-e – që nga gjuhësia gjuhëve indogjene amerikane tek indo-evropianistika, ballkanologjia, albanologjia dhe gjuhësia kelte – është një tregues i qartë i larmishmërisë së punës së tij si edhe i respektit që kolegët gëzonin për të. Eriku njihej si autori i artikujve të shkurtër, por me ndikim të gjerë, jo vetëm për disa gjuhë të Evropës, Azisë dhe Amerikës së Veriut, por edhe për gjuhësinë gjenealogjike dhe areale në përgjithësi, të cilat, siç shkroi edhe vetë: "janë që të dyja ... disiplina historike – faqe binjake të gjuhësisë diakronike, madje". Dhe ishte pikërisht në shërbim të diakronisë që Eriku ndërmori për më shumë se gjysmë shekulli ekspedita dialektologjike, të cilat na kanë dhënë sot të dhëna të çmuara sinkronike që nuk do të ekzistonin pa punën e tij. Në dy nga këto raste, kam qënë me të kur ai vizitoi një fshat që fliste arbërisht (arvanitika) dhe një fshat që fliste shqip, të dyja në Greqi, në të cilat kishte bërë ekspedita dialektologjike në vitet 1950 dhe 1960. Për habinë e tij, të dyja fshatrat ishin kthyer në fshatra njëgjuhëshe greke gjatë dekadave që kishin kaluar. Kështu, pra, Eriku, nuk ishte vetëm një shembull i historianit të gjuhës, por ishte edhe një udhëheqës ekspeditash i përkryer, që konservonte ata që rrezikonin të shuheshin dhe u jepte zë minoriteteve."

Ndarja nga jeta e profesor Eric Hampit ishte një humbje e madhe për albanologjinë, duke qënë një nga mbështetësit e saj më të mëdhenj ndërkombëtarë, dhe në përmasa më të gjera, një humbje për shkencën e gjuhësisë krahasimtare e të ballkanologjisë.

Anila Omari

